



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 154, datë 31.08.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E NJOHJES SË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE  
TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, “EURIZON CAPITAL” S.A.,  
E LICENCUAR NGA KOMISIONI I MBIKËQYRJES SË SEKTORIT FINANCIAR  
(CSSF), NË LUKSEMBURG**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 94 dhe 96, të ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe rregullores nr. 37, datë 31.03.2023 "Për njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe njohjen e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e njohjes së shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, “Eurizon Capital” S.A., e licencuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sektorit Financiar (CSSF), në Luksemburg.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**